

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË PODUJEVË - Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil, me gjyqtarin Bujar Muzaqi,- dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridiko-civile të Paditësit Sh.(B.) H., me vendbanim në Rr. “...” pn, Komuna e P., kundër të Paditurit Xh. (F.) R., me vendbanim në Rr.”” pn, Komuna e P., në çështjen kontestimore vërtetimi i të drejtës pronësore, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të paditësit Sh. (B.) H., të paditurit Xh. (F.) R., me datë 02.12.2016 morri këtë :

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET Kërkesëpadia e paditësit Sh. (B.) H., me vendbanim në Rr. “...” pn, Komuna e P.. **SI E BAZUAR.**

II. VËRTETOHET se Paditësi Sh. (B.) H., e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë e cila evidentohet si njësi Katastrale P-71712057-01168-4, vendi i quajtur “Te Podujeva”, shfrytëzimi aktual i parcelës klasa e kualitetit Arë e klasës 2, me sipërfaqe prej, 00.10.39 ha, Certifikata nr.17-5089, Komuna e Podujevës në bazë të shitblerjes.

III. DETYROHET i Padituri Xh. (F.) R., me vendbanim në Rr.” ...” pn, , Komuna e P., t’ia njohë të drejtën e pronësisë dhe t’ia lejojë që paluajtshmëria e lartcekur në evidencën kadastrale në Drejtorinë Kadastrale në Komunën e Podujevës të regjistrohet në emrin e paditësit Sh. (B.) H., në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.

IV. OBLIGOHET Paditësi që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguajë në Gjykatë shumën prej 25 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

A r s y e t i m

Paditësi në padi dhe në seancën përgaditore të mbajtur me datë 12.01.2016 ndër të tjera ka deklaruar se **“...Mbetem në tërsi pran padisë dhe kërkesëpadisë, dhe deklaroj që prona e cila është objekt i kësaj procedure kontestimore të shënohet në emrin tim, pasi që këtë pronë unë e kam blerë ne vitin 2002, e kam blerë nga F.D. , dhe prej asaj kohe unë e shfrytëzoj këtë toke, ku e kam ndërtuar edhe shtëpinë dhe gjithë herë kam menduar që kjo pronë evidentohet në emrin tim, mirëpo pas marrjes së fletës poseduese e kam pa që kjo pronë evidentohet në emër të ndjerit F. R., mirëpo unë deri me tani as një problem nuk kam pasur me djalën e të ndjerit F.R. i cili quhet Xh.R...”**

Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 02.12.2016, paditësi Sh. (B.) H., ndër të tjera deklaroi **“...Mbetem në tërsi pran padisë dhe kërkesëpadisë...”**.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

I Padituri Xh. (F.) R., në seancën përgaditore të mbajtur me datë 12.01.2016 ndër të tjera ka deklarua se **“...Nuk e kundërshtoj padinë e paditësit... dhe këtë pronë e shfrytëzon Sh. H., ndërsa prona ku gjindet shtëpia ime, sipërfaqen të cilën e shfrytëzoj ka gjithsej 33 ari, dhe gjithëherë kemi mendu se ajo tokë evidentohet në emër të babait tonë mirëpo kur kemi hulumtuar në kadastër ka dal që vetëm 22 ari evidentohen në emër të babait tim ndërsa 10 ari evidentohen në emër të Xh. D....pasi që tokën të cilën e shfrytëzon Sh. H. gjendet ma nalt se toka të cilën ne e shfrytëzojm, ndërsa për 10 ari të cilën unë e shfrytëzoj dhe evidentohet në emër të Xh. D., unë kam kontaktuar me Xh. D. i njëjti është befasuar se kjo sipërfaqe evidentohet në emër të tij dhe i njëjti ka deklaruar se nuk është asnjë problem për bartjen e kësaj toke në emër tanin...”**.

Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.02.12.2016, i padituri ndër të tjera ka deklaruar se **“...Pajtohem që kjo tokë të del në emer të Sh.H., njëherit deklaroj se nuk është gabim teknik por është bërë qëllimisht...”** .

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 02.12.2016 u administruan provat më të rëndësishme për vërtetimin e plotë dhe të drejt të gjendjes faktike siç janë : ekspertiza nga lëmia e Gjeodezisë e përpiluar me dt.01.02.2016, Çertifikata e Njesisë Kadastrale nr.P-71712011-01168-4, Çertifikata e lindjes me nr.L 21060045 e lëshuar me dt.02.11.2016, për paditësin Xh.R., Aktvendimi mbi trashëgiminë me nr të references 749/2016 e dt.25.04.2016.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, kjo Gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko – civile vërtetoi këtë gjendje faktike :

- Në bazë të Certifikatës nr.17-5089 dt.05.10.2016, u vërtetua se paluajtshmëria e cila është lëndë e këtij kontesti evidentohet në emër të F. (A.) R., gjegjësisht babait të të paditurit Xh. (F.) R..

Në bazë të Aktvendimit mbi trashëgiminë me nr. të referencës 749/2016 dt.25.04.2016, vërtetohet se ngastra kadastrale e cila është objekt i këtij kontesti e evidentuar në çertifikaten mbi palujeshtmerinë nr.P-71712011-01168-4 është shpallë trashëgimtar ligjor Xh. R., këtu i Padituri.

Në bazë të ekspertizës të përpiluar nga eksperti i Gjeodezisë P.I. me dt.01.02.2016, është vërtetuar se pas identifikimit të parceles në terren, në prani të palëve ndërgjyqëse, është konstatua se parcela për të cilën është objekt kontesti me nr.1168-4 Zona Kadastrale Obrançë, shfrytëzues është Sh. H., ndërsa sipas regjistrit të të drejtave mbi pronat e paluajtshme pronar i parcelës 1168-4 është F.(A.) R. me përpjesë 1/1.

- Në rastin konkret Gjykata vlerëson meqë i Padituri në shqyrtimin kryesor të mbajtur në Gjykatë me dt.01.12.2016 ndër të tjera deklaroi se **“...Pajtohem që kjo tokë të del në emer të Sh.H., njëherit deklaroj se nuk është gabim teknik por është bërë qëllimisht...”**, dhe në bazë të Aktvendimit mbi Trashigiminë është vërtetuar se i padituri Xh. R., është shpallë trashëgimtar ligjor i ngastrës kadastrale e cila është objekt kontesti, andaj në bazë të deklaratave të thëna në seancat gjyqësore dhe nga gjendja faktike e vërtetuar posaçërisht me thëniet e palëve ndërgjyqëse gjykata konstaton se bëhet fjalë për kërkesat që palët lirisht disponojnë në kuptim të nenit 3 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore andaj pa u lëshuar në shqyrtim të mëtejme e në kuptim të nenit 143 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe në bazë të nenit 20 par.1 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike - pronësore muar dhe shpalli aktgjykim për çka vendosi sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket shpenzimeve procedurale kjo gjykatë vendosi konform nenit 450 dhe 473 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Nenit 10.1, dhe nenit 10.12 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/12 për unifikimin e taksave gjyqësore, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimet e KGJK-së nr.20/2012 të dt. 09.03.2012 dhe nr.37/2012 i dt.23.03.2012, duke marrë parasysh që paditësi ka paguar pagesën e taksës gjyqësore, për padi në shumë prej 25 Euro, atëherë ai obligohet të paguaj taksën për Aktgjykim në shume prej 25 Euro.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË
Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.240/11 datë 02.12.2016

Gjyqtari,
Bujar Muzaqi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.